

Vendim nr. 83, datë 18.12.2025

(V- 83/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Asim Vokshi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 18.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (Sh) 2025 të Regjistrimit Themeltar që u përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA “INDUSTRI NDËRTIM” SH.P.K.,**
përfaqësuar nga avokat Ardian Kasapi, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

KUJTIM IBRAJ, përfaqësuar nga avokat Arben Llapi, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI:

Shfuqizimi i vendimeve nr. 218, datë 21.03.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 236, datë 20.04.2015 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2021-229, datë 17.02.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 4, 11, 15, 16, pika 2, 18, pika 1, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 49, pikat 3, shkronja “e” dhe 4, si dhe 50, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses, shoqërisë “Industri Ndërtim” sh.p.k., (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Kujtim Ibraj, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja, në cilësinë e sipërmarrëses, ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes nr. 2149 rep., 490 kol., datë 14.11.2009 (*kontrata e sipërmarrjes*) me subjektin e interesuar Kujtim Ibraj, në cilësinë e porositorit, për ndërtimin e dy godinave 8-katëshe në qytetin e Lezhës. Në kontratë kanë qenë të parashikuara kushtet e sipërmarrjes: pjesa takuese, afati i përfundimit të punimeve, të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, si dhe penalitetet në rast të vonësës në përfundimin e punimeve. Në kontratën e sipërmarrjes parashikohej edhe “penaliteti”, sipas të cilit për çdo vonesë në përfundimin e plotë të ndërtesës sipërmarrësi do t’i paguante pronarit të truallit, në raport me sipërfaqen reale të pjesës takuese të pambaruar të ndërtimit, penalitetin 1% në muaj. Në datën 16.11.2009 palët kanë hartuar edhe një aneks kontrate, sipas së cilës, nëse do të kishte probleme me afatin e marrjes së dokumenteve të pronësisë, për pjesët takuese të pronarit të truallit, për shkak të ndryshimeve në projektin e zbatuar me mirëkuptimin e të dyja palëve, nuk do të aplikoheshin sanksionet dhe penalitetet për kërkuesen. Subjekti i interesuar, duke pasur pretendime për mospërbushjen e detyrimeve kontraktore, konkretisht për mospërfundimin e objektit sipas kushteve të kontratës, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në datën 24.10.2011 me padi me objekt të përgjithshëm për detyrimin e kërkueses për të përmbushur kushtet sipas kontratës së sipërmarrjes së lidhur ndërmjet tyre, si dhe dëmshpërblimet përkatëse. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë janë zhvilluar gjithsej 8 (tetë) seanca përgatitore, ku kërkuesja ka qenë i pranishme vetëm në një seancë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin e ndërmjetëm të datës 23.02.2012, ia ka dërguar për kompetencë çështjen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndaj këtij vendimi subjekti i interesuar ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë, e cila, me vendimin nr. 00-2012-1456 (222), datë 03.05.2012, ka vendosur prishjen e vendimit të datës 23.02.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe dërgimin e çështjes në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit.

2. Pas kthimit të çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në datën 02.07.2012 është vendosur kalimi drejtpërdrejt i çështjes në seancë gjyqësore. Për shqyrtimin e çështjes në

themel janë zhvilluar gjithsej 16 seanca gjyqësore, gjatë të cilave kërkuesja ka marrë pjesë vetëm në një seancë nëpërmjet avokatit të saj, që ka kërkuar kohë për t'u njohur me aktet/provat (në seancën e datës 06.11.2012). Gjatë gjykimit të themelit të çështjes, në datën 06.12.2012 subjekti i interesuar ka paraqitur kërkesë për shtimin/saktësimin e objektit (vlerës) të padisë, sipas së cilës eksperti i caktuar në datën 10.09.2012 nga gjykata e shkallës së parë ka përcaktuar si vlerë të penalitetit kontraktor, 1% për çdo muaj dëmshpërblim për pjesën takuese të subjektit të interesuar, shumën 11.876.36 euro. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 218, datë 21.03.2013, (*vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë*) ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e kërkueses të përmbushë detyrimin kontraktor për llogari të subjektit të interesuar sipas kontratës së sipërmarrjes, si dhe t'i paguajë penalitetet kontraktore, 1% si dëmshpërblim për pjesën takuese të tij, në shumën 196.800 euro, si vlerë deri në datën e kryerjes së aktit të ekspertimit, si dhe vlerën shtesë 11.876.36 euro për çdo muaj pas kësaj date deri në momentin e ekzekutimit përfundimtar të vendimit. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesja, duke parashtruar, ndër të tjera, edhe pretendime për formimin e trupit gjykues.

3. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 236, datë 20.04.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me ndryshimin: detyrimin e kërkueses të përmbushë detyrimin sipas kushteve të kontratës së sipërmarrjes për të paguar penalitetet 1% në muaj, në vlerën 11.536.55 euro, detyrim i cili fillon në datën 14.05.2011 (ditën kur ka lindur detyrimi kontraktor) deri në përmbushjen e kushteve të kontratës së sipërmarrjes. Në mënyrë të përmbledhur, Gjykata e Apelit Shkodër në lidhje me pretendimin për formimin e trupit gjykues në gjykatën e shkallës së parë ka arsyetuar se është i pabazuar, sepse kërkuesja duhet ta kërkonte në seancë përgatitore dhe nuk rezulton të ketë paraqitur kërkesë si në seancën përgatitore, ashtu edhe më vonë gjatë procesit civil (*shih faqen 6 të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër*). Gjykata e apelit në përcaktimin e vlerës 1 % në muaj të penalitetit të kontratës ka përsëritur pjesërisht hetimin gjyqësor, ka thirrur po të njëjtin ekspert teknik të marrë nga gjykata e shkallës së parë dhe në përfundim e ka vlerësuar të drejtë aktin e ekspertimit për përcaktimin e çmimeve të sipërfaqeve të banimit (që nuk ishin fiksuar në kontratë) (*shih faqen 9 të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër*).

4. Kërkuesja, ndaj vendimit të gjykatës së apelit, ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, ku, ndër të tjera, ka ngritur edhe pretendime se me shtesën e objektit të padisë, vlera e saj e kalonte shumën 20 milionë lekë, ndaj gjykata ka pasur detyrimin për të pyetur palët nëse gjykimi do të duhej të vazhdonte me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë, gjë të cilën nuk e ka kryer dhe se seanca e vetme e vlefshme është ajo e datës 06.11.2012 në të cilën avokati ka

kërkuar kohë për t'u njohur me aktet e dosjes, ndërsa administratori i shoqërisë ka paraqitur raport shëndetësor dhe për këtë arsye gjykata nuk mund të vendoste gjykimin në mungesë. Gjithashtu, kërkesja ka paraqitur edhe kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 370, datë 01.07.2015, (*vendimi i pezullimit të ekzekutimit*) ka vendosur pranimin e kërkesës duke pezulluar ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe të Gjykatës së Apelit Shkodër deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

5. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2021-229, datë 17.02.2021, bazuar në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së, si dhe revokimin e vendimit të tij të pezullimit të ekzekutimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta. Në lidhje me kërkimin për gjykimin e çështjes me trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarësh, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se sipas nenit 35 të KPC-së, parimisht gjykimi në shkallë të parë zhvillohet nga një trup gjykues i përbërë me një gjyqtar, përjashtimisht, për paditë me vlerë më të lartë se 20 milionë lekë, gjykimi zhvillohet me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë nëse përmbushen dy kushte: *së pari*, njëra nga palët ndërgjyqëse kërkon që gjykimi të zhvillohet me tre gjyqtarë dhe, *së dyti*, kërkesa e palës paraqitet në seancë përgatitore, në të kundër konsiderohet e rënë në dekadencë nëse paraqitet në një moment tjetër të gjykimit. Sipas Gjykatës së Lartë, në rastin konkret nuk rezulton që kërkesja të ketë respektuar këtë dispozitë ligjore gjatë gjykimit në shkallë të parë (*shih faqen 6 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

6. Kërkesja në datën 29.09.2021 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, me objekt kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të sipërcituara. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 126, datë 29.10.2021 (*vendimi nr. 126/2021*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak të mosplotësimit të kriterit *ratione temporis*. Kolegji ka arsyetuar se referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë ka rezultuar se kjo e fundit në datën 01.02.2021 ka shpallur publikisht listën e çështjeve të cilat do të shqyrtoheshin në datën 16.02.2021, ku përfshihej edhe çështja e kërkueses. Pas këtij njoftimi, Gjykata e Lartë ka publikuar në faqen e saj zyrtare përfundimin e gjykimit të çështjes, duke publikuar edhe vendimmarrjen e saj, për rrjedhojë Kolegji ka vlerësuar datën 17.02.2021 për fillimin e afatit 4-mujor. Ndërkohë, kërkesja ka pretenduar se për vendimin e Gjykatës së Lartë ka marrë dijeni me shkresën nr. 431/1 prot., datë 04.06.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (ku ndodhej dosja përkatëse), pas kërkesës së saj për vënien në dispozicion të vendimit.

7. Pas vendimit të Kolegjit të Gjykatës, kërkuesja i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, pasi Gjykata nuk kishte pranuar për shqyrtim kërkesën për shkak të zbatimit të afatit të ri 4-mujor. *GJEDNJ*-ja, me vendimin e datës 14.01.2025 (*Ibrahimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë*), ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 6, pika 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), pasi kërkueses i ishte cenuar e drejta për t’iu drejtuar Gjykatës. *GJEDNJ*-ja ka pohuar se i takon, në radhë të parë, Gjykatës së Lartë të sigurojë që në dosjen e çështjes së saj të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve. Vendimi i *GJEDNJ*-së është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 32, datë 18.02.2025. Pas vendimit të *GJEDNJ*-së, kërkuesja në datën 06.03.2025 i është drejtuar përsëri Gjykatës me kërkesë sipas objektit, e cila është regjistruar në datën 17.03.2025, pas plotësimit të dokumenteve sipas nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës.

8. Kolegji i Gjykatës, gjatë shqyrtimit paraprak, me vendimin e datës 22.05.2025, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 126/2021 të Kolegjit, rihapjen e procesit dhe kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Në pranimin e kërkesës për rihapjen e procesit, Kolegji vlerësoi se kërkesa përmbush kriterin *ratione temporis* të parashikuar në nenin 71, shkronja “c”, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, sipas të cilit në rastin e kërkesave për rihapjen e procesit, llogaritja e afatit ligjor 4-mujor fillon nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare (nga botimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë). Në rastin konkret, vendimi i *GJEDNJ*-së është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 32, datë 18.02.2025 dhe kërkuesja i është drejtuar asaj në datën 06.03.2025, brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71, shkronja “c”, pika 4, i Ligjit Organik të Gjykatës. Gjithashtu, edhe pretendimet *ratione materiae* janë në juridiksionin e kompetencën e Gjykatës. Kolegji po në datën 22.05.2025 vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 12.06.2025 vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, në ankimin kushtetues individual të paraqitur në datën 29.09.2021 ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të:
- 9.1. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk ka garantuar të drejtën e kërkueses për t’u njoftuar

për zhvillimin e gjykimi kundër saj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka konsideruar se kërkuësja ka marrë dijëni për seancën përgatitore, edhe pse rezulton se administratori i shoqërisë nuk ka nënshkruar njoftimin, përkundrazi rubrika “Marrësi” është lënë bosh, pa asnjë shënim. Edhe pas shqyrtimit të kompetencës tokësore nga Gjykata e Lartë, çështja ka vijuar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Kjo gjykatë ka vijuar gjykimin në mungesë të kërkuëses, me argumentin se “ka marrë dijëni”. Gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Shkodër kërkuësja ka bërë kërkesë të përsëritur për përjashtimin e ekspertit, pasi nuk kishte cilësitë e duhura profesionale, pasi ishte vetëm inxhinier topograf dhe jo inxhinier ndërtimi dhe thirrjen e një eksperti të ri, ndërkohë kur gjykata e apelit ka përsëritur pjesërisht hetimin gjyqësor. Kërkuëses i është cenuar e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi në referim të vlerës së objektit të padisë (mbi 20 milionë lekë), trupi gjykues që duhej të gjykonte çështjen duhej të përbëhej nga tre gjyqtarë dhe jo nga një gjyqtar. Nëse kërkuëses do t’i ishte krijuar mundësi për të marrë pjesë në gjykim, do të kërkonte gjykimin prej tre gjyqtarësh.

- 9.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi në seancën gjyqësore të datës 06.12.2012 pala paditëse ka paraqitur kërkesë për shtimin e objektit të padisë, për të cilën kërkuësja nuk është njoftuar, pasi nuk ka pasur mundësi reale për të qenë e pranishme në gjykim, për shkak të gjendjes shëndetësore të administratorit të saj. Gjykata duhej të kishte bërë njoftimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) {ish-Qendra Kombëtare e Regjistrimit (ish-QKR-ja)} në regjistrin e shoqërive tregtare, sipas nenit 141/a të KPC-së. Kërkuësja nuk është njohur me aktin e ekspertimit të kryer në shkallë të parë, duke mos pasur mundësi të bëjë prapësimet e saj, duke iu cenuar e drejta për t’u mbrojtur.
- 9.3. *Parimit të barazisë së armëve*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka dështuar në njoftimin rregullisht të kërkuëses për zhvillimin e seancave gjyqësore. Mosmarrja dijëni dhe dështimi i gjykatës së shkallës së parë për njoftimin e kërkuëses në mënyrë të ligjshme i ka cenuar të drejtën për t’u dëgjuar, për t’i bërë pyetje ekspertit dhe aksesin substancial, duke dhunuar në këtë mënyrë parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.
- 9.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të ankimit efektiv*, pasi Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Lartë nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura nga kërkuësja në lidhje me

përbërjen e trupit gjykues, pavlefshmërinë e njoftimeve, problemet procedurale për ndërgjyqësinë, për aktin e ekspertimit dhe për përjashtimin e ekspertit. Në përmbajtje të vendimit të gjykatës së apelit nuk ka asnjë arsyetim për problematikat procedurale dhe kushtetuese të ngritura nga kërkuesja. Si gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, duke mos dëgjuar kërkuesen për pretendimet e saj dhe duke mos arsyetuar vendimet e tyre, kanë *cenuar deri në mohim të drejtën e kërkueses për ankim efektiv*.

9.5. *Lirisë së veprimtarisë ekonomike*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë vendosur rrëzimin e pretendimeve të kërkueses, duke mos u dhënë fakteve që qëndrojnë në themel të çështjes kuptimin e duhur dhe duke sjellë pasoja të pariparueshme për të. Gjykatat duhet të kishin arritur në përfundimin se parashikimi kontraktor për dorëzimin e pjesëve takuese përpara marrjes së aktit të kolaudimit është një parashikim që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, dhe si i tillë është i pavlefshëm e pa pasoja për palët. Sipas aktit të kolaudimit të vitit 2012 ka rezultuar se objekti ka përfunduar sipas lejes së ndërtimit. Në të kundërt, akti i ekspertimit i kryer nga eksperti i thirrur nga gjykata e juridiksionit të zakonshëm, i hartuar në vitin 2015, ka arritur në përfundimin se objekti ishte i papërfunduar. Gjykatat për zgjidhjen e themelit të çështjes duhet të ishin bazuar në rregullimet ligjore/nënligjore të kohës së mosmarrëveshjes dhe ishin të detyruara të zbatonin parimin “*gjykata e njeh ligjin*”. Sipas këtij parimi, edhe sikur kërkuesja të mos e kishte pretenduar, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ishin të detyruara t’i referoheshin rregullimit ligjor të fushës. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë pranuar me dashje mashtrimin e ekspertit në lidhje me faktin e mospërfundimit të punimeve. Akti i kolaudimit është hartuar e nënshkruar në datën 23.01.2012, vetëm 7 muaj pas kalimit të afatit të përfundimit të punimeve të parashikuara për në datën 14.05.2011. Në rastin më të mirë penalitetet do të duhej të llogariteshin vetëm për 7 muaj dhe vetëm për pjesën takuese.

10. ***Subjekti i interesuar, Kujtim Ibraj***, në parashtrimet e datës 10.07.2025 ka prapësuar, si vijon:

10.1. *Pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* nuk është i bazuar, pasi njoftimi për seancën përgatitore (të datës 23.02.2012) është kryer sipas nenit 130 të KPC-së. Fletëthirrja për zhvillimin e kësaj seancë është nënshkruar nga ftuesi dhe dëshmitari. Në këtë drejtim,

kërkuesja nuk ka paraqitur asnjë pretendim si ndaj ftuesit dhe dëshmitarit që ka nënshkruar fletëthirrjen apo ka paraqitur kallëzim ndaj tyre për falsitet të aktit. Kërkuesja ka qenë e pranishme nëpërmjet avokatit L.G. në seancën e datës 16.12.2012 dhe nuk ka ngritur asnjë pretendim për paligjshmëri të njoftimeve ose pavlefshmëri të akteve të njoftimit. Kërkuesja ka marrë dijeni edhe për seancën e datës 17.07.2012, pasi fletëthirrja është nënshkruar si nga postieri, ashtu dhe nga dëshmitari A.M., në këtë mënyrë njoftimi konsiderohet i rregullt. Gjykata e shkallës së parë ka vijuar gjykimin në mungesë, në zbatim të nenit 179, paragrafët e dytë dhe të tretë të KPC-së, pasi ajo gjykatë nuk mund të kryente asnjë veprim tjetër pas konfirmimit se kërkuesja kishte marrë dijeni për gjykimin dhe nuk kishte pasur asnjë shkak të justifikuar për mosparaqitjen në gjykim. Pretendimi për mosnjoftimin e kërkueses është trajtuar si nga Gjykata e Apelit Shkodër, po ashtu edhe nga Gjykata e Lartë, të cilat e kanë vlerësuar si të pabazuar dhe nuk kanë konstatuar shkelje procedurale gjatë gjykimit në shkallë të parë.

10.2. *Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, pasi gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë është bërë vetëm saktësimi i kërkimeve sipas rezultateve të aktit të ekspertimit, pasi procesi gjyqësor ka filluar me padi me objekt të përgjithshëm. Pretendimi është shqyrtuar edhe nga gjykata e apelit, që e ka vlerësuar të drejtë vendimin e shkallës së parë dhe i ka trajtuar të gjitha kërkimet e ngritura në ankim. Pretendimi për vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Shkodër, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e ekspertit, nuk është ngritur në nivel kushtetues. Gjykata e apelit i ka arsyetuar në vendimin e saj të gjitha pretendimet e paraqitura në ankim, si për aktin e ekspertimit, pavlefshmërinë e njoftimeve dhe mospjesëmarrjen në gjykim. Vendimi i gjykatës së apelit është ligjor dhe nuk cenon asnjë aspekt të të drejtave kushtetuese. Po ashtu, edhe Gjykata e Lartë ka analizuar të gjitha shkaqet e ngritura në rekurs dhe ka arritur në përfundimin se vendimet e gjykatave më të ulëta janë rrjedhojë e një procesi të ligjshëm dhe pa asnjë shkelje procedurale. Në lidhje me llogaritjen e penalitetit 1% të vlerës së punimeve të papërfunduara nuk ka pasur nevojë për njohuri të posaçme, por për njohuri minimaliste matematikore. Akti i ekspertimit që ka realizuar evidentimin e punimeve të pakryera dhe vlerën e tyre kishte përfunduar dhe ishte depozituar në dosjen gjyqësore. Për rrjedhojë, duhej*

të bëhej vetëm një llogaritje e thjeshtë matematikore, të cilën jo vetëm gjykatat, por edhe vetë palët mund ta bënin lehtësisht.

10.3. *Pretendimi për cenimin e lirisë ekonomike është i pabazuar*, pasi edhe në vitin 2023 përsëri një pjesë e konsiderueshme e objektit ishte e papërfunduar, fakt që është provuar nga një akt ekspertimi i dorëzuar në datën 13.06.2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në një proces tjetër civil. Të drejtat e subjektit të interesuar janë ende të paekzekutuara nga viti 2009 kur ka filluar marrëdhënia kontraktuale dhe nga viti 2011 kur duhej të merreshin në dorëzim sipërfaqet ndërtimore. Ndërsa kërkimi për përjashtimin e ekspertit nuk përbën shkelje kushtetuese.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për themelin e pretendimeve

11. Gjykata vëren se pretendimet *ratione materiae* të paraqitura nga kërkuesja lidhen me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, të së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor e të së drejtës së ankimit efektiv, të drejta që garantohen nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës. Gjithashtu, kërkuesja ka pretenduar edhe *cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike*, si pasojë e vendimeve gjyqësore të marra mbi bazën e provave të paligjshme. Për këtë pretendim, Gjykata konstaton se kërkuesja ka parashtruar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke mos marrë për bazë pretendimet e saj, nuk u kanë dhënë fakteve që qëndrojnë në themel të çështjes kuptimin e duhur, duke sjellë pasojat të pariparueshme për të. Sipas kërkueses, gjykatat duhej të kishin arritur në përfundimin se parashikimi kontraktor për dorëzimin e pjesëve takuese përpara marrjes së aktit të kolaudimit, është një parashikim i cili bie në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, dhe si i tillë është i pavlefshëm e pa pasojat për palët. Gjykata vlerëson se në thelb pretendimi i parashtruar nga kërkuesja lidhet me vlerësimin e provave, zbatimin e ligjit dhe të neneve të kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes palëve nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e çështjes konkrete, për rrjedhojë pretendimi do të duhet të rimerret në shqyrtim nga ato gjykata, nëse Gjykata do të gjejë shkelje të procedurës së gjykimit që rrëzon vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë.

12. Për pretendimet e tjera, për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të

*arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së ankimit efektiv, Gjykata vëren se kërkuesja të gjitha pretendimet e saj i ka lidhur me të njëjtat argumente që i referohen: i) mosnjoftimit për të qenë e pranishme në seancat përgatitore dhe gjyqësore të zhvilluara në gjykatën e shkallës së parë; ii) mospranimit të kërkesës për përjashtimin e ekspertit; iii) mosdhënies së mundësisë për të kërkuar gjykimin me trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarësh, për shkak të vlerës së padisë dhe mosnjoftimit të saj nga gjykata e shkallës së parë; iv) mosmarrjes përgjigje të arsyetuar për pretendimet e saj nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm gjatë shqyrtimit të çështjes. Për këtë arsye, në vijim, Gjykata do të analizojë në themel pretendimet e parashtruara nga kërkuesja në drejtim të *cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me gjykatën e caktuar me ligj.**

A.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

13. Kërkuesja ka pretenduar se në referim të vlerës së objektit të padisë (mbi 20 milionë lekë), gjykimi i çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë duhej të bëhej nga trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë dhe jo nga një gjyqtar. Sipas kërkueses, nëse gjykata e shkallës së parë do ta kishte njoftuar për zhvillimin e seancave, ajo do të kishte mundësi për të paraqitur kërkesë për gjykimin e çështjes me trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarësh. Sipas saj, Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Lartë nuk i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar këtij pretendimi me natyrë kushtetuese të ngritur në ankim e rekurs.

14. Subjekti i interesuar, Kujtim Ibraj, ka prapësuar se njoftimet për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë janë kryer sipas parashikimeve ligjore dhe se në seancat gjyqësore ku kërkuesja është përfaqësuar me avokat nuk ka ngritur asnjë pretendim për falsitet të fletëthirrjeve ose të nënshkrimeve të njoftuesit dhe të dëshmitarëve. Padia nuk duhet të gjykohej me trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarësh, pasi objekti i padisë pas rezultateve të aktit të ekspertimit është saktësuar dhe nuk ka pasur shtim të tij. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë analizuar dhe u kanë dhënë përgjigje të gjitha kërkimeve të kërkueses.

15. Gjykata është shprehur se arsyetimi është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe se funksioni i tij është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion

të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i standardit të arsyetimit është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 50, datë 18.10.2023; nr. 3, datë 23.01.2014; nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksionin për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 3, datë 07.02.2023; nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 27, datë 24.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në lidhje me vlerën e kërkesëpadisë, si një kusht thelbësor në përcaktimin e përbërjes së rregullt të trupit gjykues sipas dispozitave të KPC-së, Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se vlera e padisë përbën njëkohësisht një element esencial për të konkluduar për gjykatën e caktuar me ligj (*shih vendimet nr. 67, datë 06.12.2023; nr. 19, datë 25.04.2013; nr. 13, datë 18.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Sipas Gjykatës, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e *subsidiaritetit*, që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë parashtrimet e palëve, Gjykata do të verifikojë nëse kërkesja ka marrë përgjigje

përfundimtare për pretendimin e saj të ngritur në rekurs lidhur me shkeljet me natyrë kushtetuese të pretenduara që kanë ndodhur gjatë gjykimit të çështjes, duke shqyrtuar konkretisht nëse Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkueses për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.

20. Gjykata, referuar dosjes gjyqësore të administruar për efekt të gjykimit kushtetues, vëren se subjekti i interesuar Kujtim Ibraj i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me kërkesëpadi pa e përcaktuar qartë dhe në mënyrë shifrore vlerën e objektit të padisë që lidhet me detyrimin për të përmbushur detyrimin kontraktor sipas kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes tyre. Gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë nga data 08.11.2011 deri në datën 21.03.2013 (seanca për dhënien e vendimit) janë zhvilluar në tërësi 24 seanca, nga të cilat 16 seanca gjyqësore dhe pjesa tjetër seanca përgatitore. Kërkuësja nuk ka marrë pjesë në 22 seanca, për të cilat gjykata e shkallës së parë ka proceduar me njoftimin me fletëthirrje. Këto fletëthirrje në pjesën më të madhe janë firmosur nga dëshmitarë, vetëm në dy raste nga administratori dhe pjesa tjetër nga familjarë të administratorit (vëllai dhe bashkëshortja). Gjatë zhvillimit të seancës përgatitore të datës 16.01.2012 sipas përmbajtjes së procesverbalit rezulton se subjekti i interesuar, ndër të tjera, ka parashtruar se ka kryer një akt ekspertimi eksperti i zgjedhur nga ai, që mban datën 30.11.2011, ku është llogaritur vlera prej 1% (dëmshpërblimi sipas penaltetit kontraktor mujor të pretenduar në padi) e shprehur në lekë dhe shuma totale është e barabartë me 1.697.640 lekë, si dhe ka paraqitur edhe mandatpagesën që mban datën 19.12.2011, sipas së cilës ishte paguar 3% e vlerës së padisë, në shumën 280.100 lekë (gjë që tregon se në këtë moment kohor objekti real i padisë sipas taksës gjyqësore të paguar, përfshirë edhe pullat e taksës në momentin fillestar të depozitimit të padisë në gjykatë, duke marrë për bazë vlerën 3%, është nën 20 milionë lekë). Kërkuësja nëpërmjet administratorit të saj në këtë seancë ka kërkuar kohë për t'u njohur me aktet. Në seancën përgatitore të radhës, në datën 23.02.2012, kërkuësja nuk ka qenë e pranishme. Në këtë seancë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur dërgimin e çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si gjykata kompetente. Pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes për kompetencën tokësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, si gjykata kompetente, ka zhvilluar 16 seanca gjyqësore, të cilat janë shtyrë pas kërkesës së avokatit të kërkueses, duke parashtruar arsye të ndryshme, si gjendja shëndetësore ose për shkak të pjesëmarrjes në gjykime të tjera, si dhe për shkak të gjendjes shëndetësore të administratorit të shoqërisë.

21. Gjatë seancës gjyqësore të datës 06.12.2012 avokati i subjektit të interesuar/paditës në atë gjykim ka paraqitur kërkesë për shtimin/saktësimin e objektit dhe ka kërkuar kohë për pagesën e vlerës 3% të padisë sipas aktit të ekspertimit të hartuar nga eksperti i caktuar nga

gjkata, sipas të cilit vlere e padisë ishte në shumën 199.915.52 euro. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e kërkesës, duke saktësuar objektin e padisë për përmbushjen e detyrimit sipas kontratës së sipërmarrjes, për të paguar penalitetet kontraktore 1%, si dëmshpërblim në shumën 196.800 euro si vlerë deri në datën e kryerjes së aktit të ekspertimit, si dhe vlerën shtesë 11.876.36 euro, për çdo muaj pas kësaj date deri në momentin e ekzekutimit përfundimtar të vendimit gjyqësor. Po këtë ditë, sipas datës së mandatpagesës, subjekti i interesuar ka paguar 3% të vlerës së padisë në shumën 546.150 lekë. Për shkak të njoftimit të kërkueses, gjykata e shkallës së parë ka vendosur shtyrjen e seancës për në datën 20.12.2012, për të cilën kërkuësja është njoftuar me fletëthirrje. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se kërkuësja nuk është njoftuar për kërkesën për shtimin (saktësimin) e objektit të padisë. Edhe në këtë seancë (të datës 20.12.2012) kërkuësja nuk ka qenë e pranishme dhe seanca është shtyrë për në datën 08.01.2013. Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave gjyqësore pasardhëse (nga data 24.01.2013 deri në dhënien e vendimit në datën 21.03.2013), kërkuësja nuk ka qenë e pranishme, por rezulton se për dy seanca gjyqësore ka paraqitur përsëri kërkesë për shtyrje për shkak të gjendjes shëndetësore të administratorit të saj. Në seancën e datës 08.03.2013 gjykata e shkallës së parë ka vijuar me njoftimin e kërkueses nëpërmjet shpalljes në mjediset e asaj gjykatë dhe të ish-QKR-së. Në seancën e fundit të datës 21.03.2013 nga përmbajtja e procesverbalit rezulton se kërkuësja ka paraqitur kërkesë për shtyrje, duke bashkëlidhur një mandat blerjeje për një biletë udhëtimi. Po gjatë kësaj seance gjyqësore (në datën 21.03.2013) përfaqësuesi i subjektit të interesuar ka depozituar mandatpagesën (e datës 06.12.2012) për vlerën 3% të padisë dhe në përfundim gjykata e shkallës së parë është tërhequr për vendim duke vendosur pranimin e padisë.

22. Sikur u parashtrua në rrethanat e çështjes, pas ankimit të kërkueses, Gjykata e Apelit Shkodër, mes të tjerash, ka arsyetuar se kërkimi për sa i përket formimit të trupit gjykues me tre gjyqtarë, për shkak të vlerës së padisë mbi 20 milionë lekë, është i pabazuar (*shih paragrafin 3 të këtij vendimi*). Ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-229, datë 17.02.2021, objekt i ankimit kushtetues, ka arritur në përfundimin se rekursi nuk përmbushte kriteret e parashikuara nga neni 472 i KPC-së, gjykata e apelit ka respektuar normat procedurale dhe palët kanë pasur mundësi për të realizuar mbrojtjen e tyre, si dhe ka revokuar vendimin e tij për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta. Gjykata e Lartë ka arsyetuar edhe për kërkimin për gjykatën e caktuar me ligj (*shih paragrafin 5 të këtij vendimi*)

23. Për sa më lart, Gjykata ndonëse konstaton se nga procesverbalet dhe fletëthirrjet gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë kërkuësja ka kërkuar shtyrjen në të

paktën 20 seanca (përgatitore dhe gjyqësore), ajo vlerëson se megjithëse mosparaqitja e kërkueses në ndonjë rast mund të duket si e qëllimshme ose abuzive, kjo nuk i justifikon gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe Gjykatën e Lartë që të mos i japin përgjigje të argumentuar pretendimit për gjykatën e caktuar me ligj të lidhur me gjykimin e çështjes me trup gjykues me tre gjyqtarë për shkak të vlerës së objektit të padisë, të lidhur me pretendimin e kërkueses për zhvillimin në mungesë të saj të seancave gjyqësore, duke u mjaftuar vetëm me një referencë në nenin 158/a të KPC-së. Gjykata vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhej të kishin arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme për të përcaktuar momentin e marrjes dijeni nga ana e kërkueses për vlerën finale të objektit të padisë, sepse nga ky moment do të krijoheshin kushtet që ajo mund të kërkonte gjykimin e çështjes me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, si një e drejtë që i njihet nga ligji (edhe pse saktësimi i shifrës së objektit të padisë është bërë gjatë fazës së hetimit gjyqësor jo për fajin e kërkueses) ose do të parashtronte prapësimet/mbrojtjen e saj lidhur me shtimin e objektit të padisë. Në këtë kuptim, nëse seanca e datës 16.01.2012 do të konsiderohej momenti kur paditësi ka saktësuar përfundimisht vlerën monetare të objektit të padisë, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet ta kishin analizuar me kujdes këtë moment procedural, për sa kohë gjykata e shkallës së parë e ka shtyrë gjykimin për të njoftuar kërkuesen për saktësimin/shtimin e objektit të padisë. Gjykatat duhej të verifikonin nëse kërkuësja kishte marrë dijeni për vlerën totale të objektit të padisë ose jo. Gjithashtu, arsyetimi i gjykatës së apelit se subjekti i interesuar në seancën gjyqësore të datës 06.12.2012 nuk ka kërkuar shtimin e objektit të padisë, por ka saktësuar vlerën monetare të detyrimit të kërkuar në objektin e padisë (i cili deri në këtë seancë ka qenë i përgjithshëm dhe i papërcaktuar saktë), nuk është i mjaftueshëm në drejtim të respektimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi kërkuësja nuk ka marrë përgjigje për kërkimin e saj për gjykimin e çështjes nga një trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë. Po ashtu, Gjykata vlerëson se kërkuësja nuk ka marrë përgjigje edhe për pretendimin për pavlefshmërinë e klauzolës kontraktore që parashikonte penalitetin 1% mbi vlerën e detyrimit të papërbushur, e cila ishte përcaktuese për vlerën e objektit të padisë, kjo e fundit e lidhur me kërkimin e kërkueses për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Për më tepër, Gjykata vlerëson se edhe fakti që Gjykata e Lartë ka pranuar kërkesën e kërkueses për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor që përcaktonte detyrim për kërkuesen, ka qenë një tregues se, referuar shkaqeve të rekursit, në shqyrtimin e kësaj çështjeje ajo, si gjykatë ligji, duhej të tregohej më e kujdesshme në arsyetimin sa më të plotë të vendimit të saj, duke iu referuar akteve procedurale (letërthirrjeve ose procesverbaleve) të ndodhura në dosjen gjyqësore.

24. Në përmbledhje të arsytimit të mësipërm, Gjykata vlerëson se pavarësisht se në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë janë pasqyruar pretendimet e kërkuases, përfshirë edhe ato që lidhen me themelin e çështjes për sa i përket vlefshmërisë së penaltetit kontraktor, të cituara në pjesët arsyetuese të këtij vendimi, ajo nuk ka analizuar mjaftueshëm pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura nga kërkuësja në lidhje me respektimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka përmbushur standardin kushtetues të arsytimit të vendimit, si element thelbësor i vendimit të drejtë, pasi nuk u ka treguar palëve se ato janë dëgjuar rregullisht prej saj dhe se nuk u është kthyer përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të parashtruara në rekurs. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është i bazuar.

25. Në përfundim, Gjykata çmon se, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj ajo duhet të pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-229, datë 17.02.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.12.2025

Shpallur më 16.02.2026